



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 02.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **29.05.2022** të parashtruar nga **OE "Fati net" SHPK, - Drenas**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës"**, me Nr. të Prok: **616-22-1858-1-2-1** dhe numër te brendshëm **616 22 016 121** nxjerr:

VENDIM

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e **OE "Fati net" SHPK, - Drenas**, të dt. 29.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës"**, me Nr. të Prok: : **616-22-1858-1-2-1** dhe numër te brendshëm **616 22 016 121**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK kontrate te AK –së, të datës 25/05/2022.

1. Vërtetohet *kërkesa për rishqyrtim* e datës 29/05/2022, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit kontraktues.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ta kthesj ne rivleresim aktivitetin e prokurimit per Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës"*, me Nr. të Prok: : **616-22-1858-1-2-1** dhe numër te brendshëm **616 22 016 121** sipas kërkesës për rishqyrtim te datës 29.05.2022
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE "Fati net" SHPK, - Drenas me datë 29.05.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës"**, me Nr. të Prok: **616-22-1858-1-2-1** dhe numër te brendshëm **616 22 016 121**.

AK bazuar ne dy vendimet e qeverise se Kosoves dhe informatat e pranuar nga Autoritetet pergjegjese se kamerat Dahua dhe Hik vision jane produkte te futura ne listen e zeze te SHBA-ve dhe se nuk mund te instalohen ne rrjetin qeveritar mori vendim per anulim te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues she se lenda te kthehet ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit